



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 15 datë 29.02.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VKB-në NR.105 DATË 04.12.2025 PËR MIRATIMIN E KUOTAVE USHQIMORE PËR TRAJTIMIN E FËMIJËVE NË ÇERDHE DHE KOPËSH TIN ME DREKË NË BASHKINË PËRMET

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhmin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, **VKB-në nr.113 datë 17.12.2025** “Për buxhetin e bashkise viti 2026, **VKB-në nr.105 datë 04.12.2025** “Për miratimin e kuotave ushqimore për trajtimin e fëmijëve në çerdhe dhe kopshtin me drekë në Bashkinë Përmet”, Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar neni 36, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, VKM-në Nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha, për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë i ndryshuar me VKM-në Nr. 504, datë 10.9.2025; VKM-në nr.768, datë 13.12.2024 dhe VKM-në nr.67, datë 29.1.2025 neni 13/4, shkresën nr.4085 prot datë 05.12.2025 drejtuar Operatorit të Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e shërbimit me objekt “Blerje ushqime për Çerdhen dhe Kopshtin me drekë në Bashkinë Përmet për vitin 2026” LOTI i I Blerje buke gruri dhe simite nr.570 prot datë 11.02.2026, LOTI i II Blerje bulmet dhe produktet e tij nr.566 prot datë 11.02.2026, LOTI i III Blerje veze nr.568 prot datë 11.02.2026 , LOTI i IV Blerje mish i kuq dhe produktet e tij nr.569 prot datë 11.02.2026; LOTI i V Blerje mish pule nr.567 prot datë 11.02.2026, LOTI i VII Blerje ushqime koloniale nr.571 prot datë 11.02.2026, LOTI i VIII Blerje fruta perime nr.565 prot datë 11.02.2026 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Kuota ushqimore mesatare javore për trajtimin e fëmijëve në ÇERDHE me çmimet reja është në vlerën 168.95 lekë nga 225 lekë që ishte miratuar më parë pra me një efekt ulje 56.05 lekë.
 - Nga kjo shumë vlera prej 136 lekë do të mbulohet nga prindërit.
 - Dhe vlera prej 89 lekë që mbulohej më parë nga Buxheti i Bashkisë do të zbresi në vlerën 32.95 lekë.



2. Kuota ushqimore mesatare javore për trajtimin e fëmijëve në KOPËSHT ME DREKË me çmimet reja është në vlerën 204.39 lekë nga 266 lekë që ishte miratuar më parë pra me një efekt ulje 61.61 lekë.
 - Nga kjo shumë vlera prej 136 lekë do të mbulohet nga prindërit.
 - Dhe vlera prej 130 lekë që mbulohej më parë nga Buxheti i Bashkisë do të zbresi në vlerën 68.39 lekë.
3. Shpenzimet për mbulimin dhe blerjen e ushqimeve të përballohen nga buxheti i vitit 2026.
4. Efektet e zbatimit të këtij vendimi do të nisin që prej lidhjes së kontratave me secilin Operator Ekonomik për secilin lot.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social/Arsim/Kulturë/Sporte, Drejtoria e Kopshteve dhe Drejtoria e Financës/Shërbimeve Mbështetëse.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

KRYETAR
Anila DHIMITRI

